



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0322

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga, Isa Hasani-kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Grupit i Operatoreve Ekonomik (GOE) Eco Clean & Energy; Dardaniaa Sh.P.K kundër Vendimin për dhënie të një kontratë të Komuna e Vushtrrisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve me numër të prokurimit: “VU644-23- 14245-2-1-1” me, 13/08/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e GOE; Eco Clean & Energy; Dardaniaa Sh.P.K, me numër;2024/0322, e datës 15/04/2024, kundër vendimit të Autoritetit kontraktues- Komuna e Vushtrrisë, të datës,28/03/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve” me numër të prokurimit: “VU644-23- 14245-2-1-1”.
2. Anulohet,” Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues” për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve” me numër të prokurimit: “VU644-23- 14245-2-1-1”, AK – Komuna Vushtrrisë dhe lënda kthehet në Rivlerësim.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Lejohet kthimi i tarifës për ankesë, në vlerën e deponuar për paraqitjen e ankesës, GOE; Eco Clean & Energy; Dardaniaa Sh.P.K, sipas nenit 31.4. OE obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për tërheqje të depozitës për sigurim të ankesës, në të kundërtën bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Më, 27.12.2023, Komuna e Vushtrrisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve me numër të prokurimit: “VU644-23- 14245-2-1-1”. Ndërsa me datën 28.03.2024 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë GOE “NNP Hysnia & POUK Group Sh.P.K – Vushtri.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 180,543.80 €.

Me 02.04.2024, GOE “Eco Clean & Energy; Dardaniaa” Sh.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 05.04.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 15.04.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga GOE Eco Clean & Energy; Dardaniaa Sh.P.K me nr. 322/24 për lidhur me aktivitetin “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve me numër të prokurimit: “VU644-23- 14245-2-1-1”.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

-Pretendimet e grupit te operatoreve ekonomik ankues Eco Clean & Energy; Dardaniaa Sh.P.K janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I): “Pas ngarkimit ne platformën elektronike e-prokurim te B58 njoftimit mbi vendimin e AK ku është shpallur përsëri GOE NNP Hsnia & POUK Group ShPK me date 28.03.2024 për dhënie te kontratës, ne me date 29.03.2024 kemi kërkuar qasje ne dokumente sipas nenit 10 te LPP-se duke sqaruar se AK te na i dërgoj përmes e-maili apo/ose përmes platformës elektronike sepse koha kur është shpallur vendimi B5 është kufizim sepse përveç ditës se Premte qe ka qene dite pune ditët tjera janë dite pushim dhe dita e fundit për KpR është dita e MARTE date 02.04.2024 (për shkak te festave zyrtare). Andaj AK e ka menduar dhe planifikuar ne detaje këtë kufizim dhe marr për baze nenin 10 te LPP-se AK është i obliguar qe qasjen te ne mundësoj edhe përmes e-mail apo edhe platforme pa qene nevoja te jemi fizikisht ne zyret e AK – krejt kjo fale nenit 10 te LPP-se. Mirëpo AK na diskriminon dhe e favorizon hapur GOE te cilin e ka shpallur përsëri për dhënie te kontratës dhe sipas qasjes qe ne kemi pasur para KpR qe kemi ngritur me pretendimet tona dhe te cilat përsëri po pretendojmë se edhe nëse ka pasur sqarime ky GOE nuk ka mundur te behet i përgjegjshëm sepse edhe nëse ka dorëzuar sqarime krejt këto sqarime janë ne kundërshtim me Nenin 72 PAR. 3 TE LPP-se, sepse dokumentet dhe te dëshmohen para datës se hapjes dhe pas kësaj date, andaj ne jemi diskriminuar duke na pamundësuar te rekomandohemi për dhënie te kontratës, andaj ne do te konsultohemi edhe me avokatin tone për mbrojtur drejtat tone pasi qe konsiderojmë se jemi

diskriminuar hapur nga AK dhe do te ju drejtohem i organeve kompetentet për këto veprime te AK.ESH ti shpalos këto fakte dhe prova tona dhe te rekomandoj për anulimin e vendimit B58 dhe lënda te kthehet ne rivlerësim pasi vetëm GOE ynë është i përgjegjshëm ne këtë AP.”

Pretendimi i dyte (II) : “AK – komisioni i vlerësimit ka rekomanduar për dhënie te kontratës një OE te papërgjegjshëm duke mos i kërkuar fare sqarime sipas nenit 61 te LPP-se dhe nenit 41.3 te Rregullore Nr. 01/2022 për prokurim publik edhe për kundër se janë plotësuar te gjitha kushtet për kërkuar sqarime po ofrojmë fakte dhe dëshmitë janë te bashkangjitura ne ankese. Këtu plotësohen te tri (3) kushtet për çimim jo normalisht të ulet! Për ofertën nr. 2 ne pajtim me nenin 61 të LPP-së dhe nenin 41.3 të Rregulloren Nr. 01/2022 per Prokurim Publik. Me fjalë tjera oferta nr. 2 ne vlere: 89592.00 € i plotëson te tri (3) kushtet për ta eliminuar si ofertë jo normalisht të ulët në këtë aktivitet të prokurimit. Pozicioni me nr. 1 me cmime prej : 30.00 Euro eshte cmim jo normalisht I ulet per faktin se ne po bashkangjesim Profaturen nga ku edhe furnizohemi: dhe kur te llogaritiet 1 ton krip kushton 35 euro ne Vlore Shqiperi, + dogana dhe TVSH: 10.50 euro + transporti 40 euro per ton totali dele: 85.50 Euro vetem furnizimi, pa llogaritu transportin dhe hedhjen per rruget qe do mirembahen ne teritorin e komunes se Vushtrrise, prandaj cmimi i dhene nga OE NNP HYSNI eshte cmim jo normalisht i ulet, Lusim AK - komisioni e vleresimit te hulumtjtn dhe analizojne ashtu sic i obligon LPP-se gjate vleresimit te tendereve dhe te konstatohet se cmimiprej 30 Euro eshte vertet qesharak dhejo normalisht i ulet sepse vetem blera ne vend VLORE kushton 35 Euro. Prove: profatura nga furnizuesi yne!. Pozicioni me nr. 2 me cmime prej : 8 euro e reres vetem blerja e reres kushto prej 8 EURO deri ne 10 EURO pa llogaritur transportin dhe hedhjen e reres. Prandaj edhe ky cmime eshte jo normalisht I ulet dhe jo cmim i tregut. Lusim AK – KV te hulumtojn cmimet e tregut??!.....Jemi brenda vlere se parashikur nga AK dhe kemi ofruar cmime reale pasi qe jemi te specializuar ne keto sherbiem!..... Pozicionet 3, 4, 5 dhe 6 jan cmime manipulative pasi qe nuk jane cmime identike sepse behet fjale "puna efektive e kamionit" si mund te dalloj ky cmim ne keto sherbime perveq se jane cmime manipulative gje qe e ban te pa zbatushme kontraten dhe dyshim per korrupsion, Shikoni cmime tona jan identike per keto pozicion ne vlere 25 euro jane reale te tregut dhe jo manipulative!... Pozicionet 7, 8, dhe 9 jan cmime manipulative pasi qe nuk jane cmime identike sepse behet fjale "puna efektive e ngarkuesit" si mund te dalloj ky cmim ne keto sherbime perveq se jane cmime manipulative gje qe e ban te pa zbatushme kontraten dhe dyshim per korrupsion, Shikoni cmime tona jan identike per keto pozicion ne vlere 40 euro jane rale te tregut dhe manipulative!... Hulumtone tregun!... Pozicionet 13 janë cmime jo normalisht te uleta sepse kujdestaria aktive me cmim prej 1 euro eshte qesharak dhe absurde duke marr per baze se AK tek kriteret e perzgjedhjes konkretisht kerkesat mbimundesit teknik dhe profesional te FDT-se ka kerkuar: Kërkesa 4. Operatori ekonomik duhet të ketë staf teknik në të cilët operatori ekonomik mund të thirret për realizimin e projektit dhe atë minimum nezet (20) Puntor teknik - ndihmës. Prandaj ku është logjika e shnosh ndash me ore me llogarit por edhe me dite është e pamundur te mbulohen vetëm pagat e punëtorëve qe do te jene ne gjendje gateshim për angazhimin ne këtë pozicion për këtë shërbim te kësaj natyre, ska punëtorë me ore prej 1 euro qe paguhet sepse kjo përben edhe shkelje e ligjit te punës dhe shkelje e nenit 61 LPP-se, si dhe nenit 17.26 dhe 17.27 te Rregullores Nr. 001/2022 për prokurim publik sepse nuk mbulohen pagat e punëtorëve, lusim AL te analizoj dhe te konstatoj ku ka punëtorë qe paguhet për ore prej 1 euro ora, duke mos harruar se punës e natës dhe puna e vikendeve dhe festave paguhet sipas ligjit te punës me 50% dhe 30% me shume?????!!...Këto çmime janë qesharak dhe sigurisht jo normalisht te ulëta dhe me automatizëm ky GOE është i pa përgjegjshëm sipas nenit 61 te LPP-se, sepse nuk mbulon as pagat e punëtorëve dhe këtë e rregullon LPP se për pozicion qe nuk mbulohen pagat apo nuk mbrohen te drejtat e punëtorëve OE duhet te eliminohen dhe te shpallen te papërgjegjshëm sipas nenit 61 LPP-se, si dhe nenit 17.26 dhe 17.27 te Rregullores Nr.

001/2022 për prokurim publik. Por AK - Komisioni i vlerësimit, gjate kohës sa kemi qen ne qasje nuk na kane dhënë dëshmi se AK - Komisioni i vlerësimit ka kërkuar sqarime për çmime jo normalisht te ulëta, qe do te thotë se Komisioni i vlerësimit ka qene jo profesional ku sipas nenit 59 par. 1 te LPP-se, dhe rregulloren 39.5 te RR. Nr. 001/2022 për PP sepse komisioni i vlerësimit duhet te posedoje aftësi të duhura, njohuri dhe përvojë, relevante me kërkesat e prokurimit, dhe te respektoj dispozite ligjo re te LPP-se, konkretisht nenin 59 te LPP-se te vlerësoj , ekzaminoj dhe krahasoj tenderët ne baze te njoftimit për kontrate dhe dosjes se tenderit, gjë te cilën Komisioni vlerësimit nuk e ka bere a dështuar dhe ka vepruar ne Kundërshtim me nenin 59 par. 4 te LPP-se, duke qene subjektiv dhe te njëanësh me rastin e rekomandimit te OE NNP HYSNI - Këtë pretendim tone e argumenton edhe Raporti i vlerësimit i nënshkruar nga Komisioni i vlerësimit se nuk ka kërkuar faqe sqarime dhe duke shkelur edhe nenin 7 te LPP-se duke ne diskriminuar dhe favorizuar OE i cili vepron ne komunën e tyre dhe i cili nuk është i specializuar ne kryerjen e këtyre shërbimeve, por është favorizuar ne shkelje te nenit 7 te LPP-se. Nuk e kemi pas mundësin te shikojmë përgjigjen qe ka dhënë OE i rekomanduar, nëse AK i ka kërkuar sqarime, por nuk ka matematik qe e benë te përgjegjshëm sepse çmimet e tregut shume lehte vërtetohen dhe argumentohen ne kemi prova dhe fakte te çmimeve te tregut – këtë e dëshmon edhe neni 41 i LPP-se, dhe çmimet qe kemi tenderua ne. AK e favorizon OE e rekomanduar për kontrate pasi qe janë plotësuar te gjitha kushtet te eliminohet se tenderues me çmime jo normalisht te ulëta dhe rrezikon te hyje ne marrëdhënie kontraktual me një OE i cili nuk do ta realizoj pasi qe me ato çmime me te ulëta se çmimet e tregut nuk do te ekzekutohen.”

Pretendimi i katërt (IV) : “AK ne dosje te tenderit si dokument themelor per pergaditjen e tendereve nga OE ke percaktuar 7/4 kërkesat mbi mundesit teknike dhe/ose profesionale ne nenin 9.1 & 9.2 te FDT-se tek kerkesa 1/dëshmia 1 ka percaktuar si me poshte: Kerkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë), ne vlere minimale 216,000.00 Ne rastet e ofertimit si Grupi I OE-ve, nga lideri I grupit kerkohet qe ta permbush min 60% te vlerese se kerkuar . Dëshmia 1 Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 7 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje me sukses te punëve. Ndera AK – Komisioni i vlerësimit ka rekomanduar për dhënie te kontratës një GOE i cili përveç qe arrin te plotësoj këtë kërkesë, sipas qasjes qe kemi pranuar AK i ka kërkuar edhe sqarime OE për te sjelle një reference për një AK i cili fare ska te beje me natyrën e këtyre shërbimeve, dhe as qe mund te quhet i ngjashëm apo i përafërt sepse me një klikim ne platformën elektronike e gjeni këtë kontrate dhe paramane qe ka realizuar me Komunën e Obiliqit dhe asnjë pozicion ska te beje as për se afërmi dhe nuk mund te pranohet se kontrate e ngjashme sepse kjo posedon numrin 5-2-1 qe dot e thotë është pune dhe nuk është shërbim fare dhe sigurisht nuk arrin te plotësoj kërkesën 1 dhe dëshminë 1, pasi qe kjo kontrate është pune dhe nuk hyn te shërbimet dhe nuk mund te pranohet si kontrate e ngjashme. Përveç kësaj kjo reference e pranuar nga Komisioni i pranimi (i cili komision ka qene jo profesional sipas nenit 59 par. 1 te LPP-se) edhe pas sqarimet e pranuar nga OE NNP Hysnia, me rastise pranimi ka shkelur edhe nenin 72 par. 3 te LPP-se, ku thotë: Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive., sepse ku reference mban datën 26.02.2024 kur është lëshuar dhe ky dokument sigurisht përbënë ndryshim material dhe nuk është i pranueshëm?!..Edhe pas aprovimit te kërkesë tone për rishqyrtim nga AK dhe ne raste te sqarimeve për OE te rekomanduar për dhënie te kontratës përsëri ky OE nuk ka mundur te behet i përgjegjshëm sepse nuk plotëson kërkesën për kontrata te ngjashme dhe punët e ndërtimit te ulet nuk janë kontrata te

ngjashme dhe ky OE posedon vetëm një referen për pastrim bore dhe e cila nuk arrin vlerën e përcaktuar nga AK 216000.00 Euro. ESH te trajtoj drejt dhe te shtjelloj drejt pretendimet tona si dhe PSH te konstato se jemi diskriminuar dhe është favorizuar OE i rekomanduar për dhënie te kontratës. Prove: Paramasa dhe parallogarit e kësaj kontrate është e bashkangjitur ne ankese. Pra me këtë veprim nga AK – Komisioni i vlerësimit cili nga këto pune mund te pranohet si kontrata dhe referenca (ne kundërshtim me nenin 72 te LPP-se) se janë te ngjashme, kjo nuk do komentet se këtu ska te beje fare me kontrate te ngjashme por AK ka vepruar ne kundërshtim me nenin 7 dhe 59 te LPP-se, duke na diskriminuar dhe duke favorizuar GOE për dhënie te kontratës edhe përkundër se nuk a arrit te plotësoj kriteret e përzgjedhjes te përcaktuar ne dosje te tenderit për këtë AP.”

Pretendimi i pestë (V) : “AK ne dosje te tenderit si dokument themelor për përgatitjen e tenderëve nga OE ke përcaktuar kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale ne nenin 9.1 & 9.2 te FDT-se tek kërkesa 1/dëshmia 1 ka përcaktuar si me poshtë: Kërkesa 2.Vlersimi i rrishtut për kompani nga një kompani e licencuar nga organi kopotent (MPMS) . Shënim Në rast të konzorciumit, udhëheqësi i grupit duhet të këtë kryer vlerësimin e rrishtut Dëshmia 2.Vlersimi i rrishtut për kompani te dëshmohet me vërtetim nga një kompani e licencuar nga organi kompetent (MPMS) se ka kryer vlerësimin e rrishtut konform ligjit 04 L-161 vërtetimi duhet te jete i noterizuar) - Liderin. AK ka rekomanduar për kontrate OE NNP Hysnia i cili ka ofruar kete dokumente dhe i cili nuk është sipas kërkesa dhe dëshmisë si me herët te kërkuar ne dosje tenderit, pasi dokumenti mbi vlerësimin e rrishtut – Vërtetimi nuk është i noterizuar, po ashtu mungon edhe licenca e kompanisë qe ka lëshuar këtë vërtetim pasi qe sipas ligjit Nr. 04/L-161 këto kompani duhet te kenë licenca për këto pune??? dhe AK – komisioni i vlerësimit nuk ka vlerësuar drejtë me rastin e pranimit te këtij dokumenti duke shkelur nenin 7 te LPP-se dhe nenin 59.2 dhe 72 te LPP-se, duke kërkuar sqarime por me kusht qe këto sqarimet e jene ne pajtim te plote me nenin 72 par. 3 te LPP-se, andaj me këtë veprim AK – komisioni i vlerësimit kane qen subjektive duke favorizuar OE NNP Hysnia duke shkelur dispozitat ligjore te LPP-se. Ky dokumente edhe nëse ka qene i noterizuar para datës se hapjes është ne rregull por nëse ka dorëzuar datën e noterizimit pas datës se hapjes është ndryshim material sipas nenit 72 par. 3 te LPP-se. AK nuk ka respektuar këto dispozita te LPP-se duke ne diskriminuar ne si OE pale me interes ne këtë aktivitet te prokurimit, dhe duke e favorizuar OE te rekomanduar për kontrate.”

Pretendimi i gjashtë (VI) : “AK ne dosje te tenderit si dokument themelor për përgatitjen e tenderëve nga OE ke përcaktuar kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale ne nenin 9.1 & 9.2 te FDT-se tek kërkesa 1/dëshmia 1 ka përcaktuar si me poshtë: 9/4 Kërkesa 3. Operatori ekonomik duhet të angazhoj këtë staf profesionale në veçanti, të personit që drejtpërdrejt është përgjegjës për realizimin e projekteve të punës ose për realizimin e aktiviteteve ndërtimore; Një (1) Bachelor i Ndërtimtarisë apo master, (drejtimi Konstruktiv), i emëruar me vendim menaxher dhe përgjegjës i drejtpërdrejt për ekzekutimin e projektit. Dëshmia 3. Lista e stafit profesional e nënshkruar dhe e vulosur, listës duhet të i bashkëngjiten këto dëshmi CV-ja e nënshkruar nga inxhinieri; Diploma, duhet të jetë e noteruar; Kontrata apo Para kontrata e punës e nënshkruar nga Punëmarrësi si dhe e nënshkruar dhe e vulosur nga Punëdhënësi. Vendimi mbi emërimin e menaxherit të projektit i cili duhet të jetë i nënshkruar dhe i vulosur. AK – komisioni i vlerësimit me rastin e vlerësimit ka shkelu nenin 59 te LPP-se, pasi qe CV-ja për Inxh. z.Azem Gashi nuk është e nënshkruar nga Inxh. dhe kjo ka qene kërkesa ne dosje te tenderit, andaj komisioni i vlerësimit është dashur te lenoj këtë OE si te papërgjegjshëm sepse nënshkrimi i CV-se nuk është dokument qe mund te konstatohet se ka ekzistuar para datës se hapjes ashtu siç obligon nenin 72 par. 3 i LPP-se, andaj me këtë veprim AK – Komisioni i vlerësimit konstatohet se përveç qe ka qen jo profesional ai ka qene edhe subjektive me rastin e vlerësimit duke rekomanduar një OE te

papërgjegjshëm për dhënie të kontratës. Edhe nëse është dorëzuar CV e nënshkruar nga INHX... përsëri paraqet ndryshim material sipas nenit 72 par. 3 të LPP-se dhe lejmi i këtij veprim nga AK është në kundërshtim me nenin 7 dhe 59 të LPP-se. AK – Komisioni i vlerësimit ka shkelur këto dispozita ligjore të LPP-se duke e favorizuar OE të rekomanduar për kontratë duke na eliminuar dhe diskriminuar në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-se.”

Pretendimi i shtatë (VII) : “AK në dosje të tenderit si dokument themelor për përgatitjen e tenderëve nga OE ke përcaktuar kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale në nenin 9.1 & 9.2 të FDT-se tek kërkesa 1/dëshmia 1 ka përcaktuar si me poshtë: Kërkesa 4. Operatori ekonomik duhet të ketë staf teknik në të cilët operatori ekonomik mund të thirret për realizimin e projektit dhe atë minimum njëzet (20) Punëtorë teknik - ndihmës. Dëshmia 4. Lista e punëtorëve teknik me të dhënat e tyre e nënshkruar dhe e vulosur, të cilët duhen dëshmuar me Kontratë të punës apo Para kontratë të punës të nënshkruar nga Punëdhënësi dhe Punëmarrësi si dhe e vulosur nga Punëdhënësi. AK ka rekomanduar për dhënie të kontratës GOE NNP Hysnia & POUK Group ShPK të cilët janë të pa përgjegjshëm sepse OE NNP HYSNIA ka sjelle listën e stafit me nr. rendr 20, por nga kjo liste janë 6 inxhiner (këtu hyn dhe menaxheri i kontratës) që dot e thotë se në këtë liste janë 14 punëtorë teknik – ndihmës, ndërsa anëtari tjetër POUK Group ShPK ka dorëzuar një liste të stafit me nr. rendor prej 5 veta mirëpo dy (2) veta janë inxhiner ndërsa tre (3) veta janë staf teknik ndihmës, që dot e thotë se komplet ka prezantuar vetëm 17 punëtorë teknik – ndihmës, përveç kësaj punëtori z, Arbore Sabani nuk e kat e nënshkruar kontratën që dot e thotë se kjo kontratë është e falsifikuar dhe e papranueshme duke marr për bazë kërkesën dhe dëshminë e dosjes së tenderit si me lart që dot e thotë se AK – komisioni i vlerësimit me këtë veprim ka shkelur nenin 7 dhe nenin 59 të LPP-se, duke e rekomanduar për dhënë të kontratës një GOE të papërgjegjshëm pasi që i njëjti nuk ka arrit të plotësoj kriteret e përzgjedhjes dhe është administrativisht i papërgjegjshëm dhe nuk mund të aplikohet neni 72 i LPP-se. Bazuar në qasje që kemi qene në vlerësim e pare është konstatuar se i mungon nr. i punëtorëve dhe nëse ka dorëzuar pas datës së hapjes tjetër punëtorë është shkelje e nenit 7, 59 dhe 72 të LPP-se. Kërkojmë nga ESH të analizoj dokumentet dhe provat në platformën elektronike dhe dokumentet e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë dhe të konstatoj se është OE i 10/4 papërgjegjshëm pasi që nuk ka arrit të plotësoj kriteret e përzgjedhjes dhe kriterin e dosjes së tenderit.”

Pretendimi i tetë (VIII) : “AK në dosje të tenderit si dokument themelor për përgatitjen e tenderëve nga OE ke përcaktuar kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale në nenin 9.1 & 9.2 të FDT-se tek kërkesa 1/dëshmia 1 ka përcaktuar si me poshtë: Kërkesa 5. Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit Pasjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT Dëshmia 5. Lista për mekanizimin dhe pajisjet sipas Aneksit 7. e cila duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur dhe listes duhet të bashkangjitet Një deklaratë me shkrim e nënshkruar dhe e vulosur me të cilën deklaron se i posedon makinerit dhe pajisjet e listuara në Aneksin nr.7 të DT_s .ndërsa, makineria në dispozicion duhet të dëshmohet me njërin prej këtyre dëshmimeve kopje të librezës së qarkullimit, DUD doganorë, faturë për blerjen ose kontrata apo marrëveshje mbi qiramarrjen të cilës duhet të bashkangjitet edhe dokumenti i automjetit me të cilën dëshmohet pronësia në emër të qiradhënësit, Vërejtje Automjetet duhet të jenë me librezë dhe me regjistrim valid. AK ka rekomanduar për dhënie të kontratës GOE i cili është i papërgjegjshëm pasi nuk ka arrit të plotësoj kriteret e përzgjedhjes duke prezantuar dy (2) traktore të cilat nuk janë të regjistruar – dmth mungojnë librezat e qarkullimit dmth automjete të cilat dalin në qarkullim janë të obliguar tek enë regjistrim valid, andaj traktorat e prezantuar nga OE pa librezë qarkullimi është në kundërshtim me dosjen e tenderit si sipas ligjit mbi qarkullimin e mjeteve

metrik ku thote: çdo mjet bujqësor që është në qarkullim qoftë dhe në periudha sezonale duhet të jetë i regjistruar dhe kjo është një praktikë që zbatohet pothuajse në të gjitha vendet e BE-së. Po ashtu bazuar në ligjin Nr. 05/L-132 për automjete traktorët duhet të regjistrohen nëse dalin në qarkullim në rrugën rajonale dhe lokale, andaj kryerja e natyrës së kësaj kontrate me traktor pa libereze qarkullimi është e ndaluar me ligjin e cituar më lart për automjete si dhe AK vete e ka përcaktuar se automjete duhet të jenë me libereze dhe me regjistrim valid, andaj me këtë veprim AK – komisioni i vlerësimit ka shkelur nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së, pasi që nuk ka kërkuar librezën e qarkullimi valid ashtu siç e ka përcaktuar në dosjen e tenderit në pajtim me nenin 72 par. 3 të LPP-së. AK – Komisioni i vlerësimit me rastin e rekomandimit të GOE për dhënie të kontratës i cili nuk ka dorëzuar deklaratën të nënshkruar dhe të vëlosur me të cilën deklaroi se i posedon makinerinë dhe pajisjet ashtu siç e ka kërkuar në dosje të tenderit kërkesa5/dëshmia5 në dosje të tenderit, d.m.th. i mungon kjo deklaratë ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit dhe me këtë veprim AK – ZPP si dhe Komisioni i vlerësimit kanë shkelur nenin 7, 59 dhe 60 të LPP-së duke rekomanduar një GOE të pa përgjegjshëm dhe i cili nuk ka arritur të plotësojë kriteret e përzgjedhjes si dhe ka tenderuar me çmime jo normalisht të ulëta dhe manipulative gjë që e bënë një kontratë të dëmshme, të pa zbatueshme dhe dëmshme sepse nuk ka kapacitet as profesional, as teknik dhe fuqi punëtore për të ofruar shërbime të mirëmbajtjes dimërore gjë që paraqet rrezik për shëndetin e qytetarëve në Komunën e Vushtrrisë, prandaj kjo prek edhe interesin publik andaj lusim AK të analizojë dhe të respektojë në tërësi dispozitat ligjore të LPP-së, duke analizuar dhe hulumtuar tregun dhe çmime me të cilat kemi ofertuar në këtë AP brenda vlerësimit të parashikuar nga vete AK – NJK në këtë procedurë prokurimi. Gjithashtu, GOE i rekomanduar për kontratë edhe i papërgjegjshëm për faktin se i mungon ngarkuesi për peshë min. 2000Kg, që dot e thotë se nuk e plotëson këtë kërkesë dhe i është i papërgjegjshëm.”

Pretendimi i nëntë (IX) : “Në pajtohemi me AK me rastin e eliminimit të këtij GOE të cilët nuk kanë arritur të plotësojnë kriteret e përzgjedhjes të përcaktuar në dosjen e tenderit si dokument themelor për përgatitjen e tenderëve nga OE, dhe konsiderojmë se ky GOE janë të papërgjegjshëm dhe nuk kanë Interes juridik material sipas nenit 4 par. 1.26 të LPP-së. Po ashtu në pretendojmë se ky GOE janë të pa përgjegjshëm edhe për faktin se me rastin e tenderimit në këtë AP e bëjnë edhe akoma me të papërgjegjshëm sepse i mungojnë edhe dok si në vijim: 1. Mungojnë punëtorët teknik ndihmës ashtu si qeshtë kërkuar në dosje të tenderit 2. Mungon noterizimi i vlerësimit të rrishtit 3. Mungojnë librezat e qarkullimit –valide të traktorit 4x4 dhe të traktorit për pastrimin e bores 4. Mungon Luga ngarkues min 5 ton 5. Mungon kamioni kiper me peshë bartëse min. 17 ton (2 cope) 6. Mungon eskavatori deri min. 1.5 ton 7. Mungon deklaratë me shkrim ku deklaroi se i posedo makineritë dhe pajisjet e kërkuar në aneksin 7 të FDT-së Prandaj, bazuar në këto fakte dhe dëshmi që i mungojnë këtij GOE e të cilat e bëjnë të papërgjegjshëm sepse nuk arrin të plotësojë kriteret e përzgjedhjes të përcaktuar në dosje të tenderit dhënë njoftimin për kontratë dhe dëshmon se Komisioni i vlerësimit ka qenë jo profesional duke shkelur nenin 59 par. 1 të LPP-së dhe nenin 59 par. 4 të LPP-së me rastin e vlerësimit të tenderëve në këtë AP. Të gjitha këto fakte dhe dëshmi të ofruar nga ana jone janë profesional dhe nuk mund të kontestohen nga asnjë ZPP – njohës i fushës së prokurimit sepse nuk ka logjik dhe as kuptim të jenë ndryshe sepse shkelen standardet dhe rregullat profesionale të LPP-së, prandaj arsyetimet e dhëna nga jone janë të mbështetur në dispozite ligjore ashtu siç kemi potencuar në këtë KpR, duke i mundësuar AK – ZPP të aprovojë kërkesën tone dhe të shqyrtojë kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale në funksion të qëllimit të prokurimit për këtë aktivitet të prokurimit duke rekomanduar NE si GOE të vetmit të përgjegjshëm dhe me çmime brenda vlerësimit të parashikuar të përcaktuar nga vete AK-NJK në këtë procedurë prokurimi, duke caktuar një Komision të vlerësimit në pajtim me nenin 59 par. 1 të LPP-së dhe rekomanduar për kontratë vetëm GOE që i plotëson kriteret e përzgjedhjes dhe është profesional në ekzekutimin e kësaj

kontrate duke realizuar shërbime profesionale dhe ne funksion te qyteteve te Komunës se Vushtrrisë, duke mbrojtur edhe interesin publik për te marr e këto shërbime qyqaret për kushtet e vështira ne rast te reshjeve te bores. . AK me rastin e rekomandimit për dhënie te kontratës GOE: NNP HYSNI & POUK Group ShPK te cilët janë te papërgjegjshëm për këtë aktivitet te prokurimit AK - komisioni i vlerësimit kane shkelur nenin 1, 2, 7, 52, 53, 59, 60, 61 dhe 72 te LPP-së, për faktin se kane vepruar ne kundërshtim me dispozitat ligjore te LPP-se ashtu siç potencuam me larte, prandaj kërkojmë nga AK – ZPP – NJK te marrin përgjegjësi dhe te veprojnë ne te kundërtën ne do te detyrohemi te drejtohem institucioneve relevante. PROVE: Konsultimi i dispozitave ligjore te LPP-se te faktuar dhe argumentuar ne këtë KpR tani Ankese ne OSHP Duke u bazuar ne dëshmitë dhe faktet qe u ceken me lartë rezulton se AK – ZPP ka shkelur Paragrafi 1 i nenit 7 te LPP-së e parasheh qarte qe “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët 12/4 ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”, ndërsa AK-ja nuk e ka zbatuar ketë dispozitë sepse neve na ka diskriminuar, duke mos na rekomanduar për kontrate. Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur ne konsideratë edhe nenin 1 te LPP-së, pasi qe dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën me efikase, me transparente dhe me te drejt te shfrytëzimit te fondeve publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve te tjera te autoriteteve kontraktues ne Kosovës.”

-Përgjigje e AK-Komuna Vushtrrisë në Kërkesën për rishqyrtim-

Autoriteti Kontraktues pasi i shqyrtoi pretendimin e Ankuesit të parashtruar në Kërkesë për Rishqyrtim dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës, gjeti se Kërkesa e Ankuesit Është e pabazë, për arsye se: Procedura është zhvilluar bazuar në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Sipas nenit 1 të LPP-së , A.K. ka pasur për qëllim që, bazuar në kushtet dhe rregullat e specifikuar, procedurën e zbatuar, të siguroj mënyrën me efikase me transparente dhe me të drejte të realizoi shfrytëzimin e fondeve publike dhe burimeve publike te AK. , neni 6 - ka pasur për qëllim që t’ë sigurohet që fondet publike dhe burimet publike të përdoren - shfrytëzohen në mënyrë me ekonomike duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ndërsa neni 7 ka pasur për qëllim trajtimin e barabartë, pa diskriminuar asnjë prej OE. pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, neni 33 paragrafi 1 (Procedurë e Hapur) ka pasur për qëllim promovimin e transparencës, neni 59 (Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve) lidhur me nenin 60 paragrafi 1 pika 1.1 (tenderi i përgjegjshëm me çmimin me të ulët) ka pasur për qëllim, të bazuar në të gjeturat dhe rezultatet nga procesi i ekzaminimit dhe vlerësimi te tenderëve, të vendosë në mënyrë meritore. Mbi këtë bazë AK vlerëson se Vendimi i AK. i dt. 29.03.2024 është marrë bazuar në kushtet, rregullat dhe procedurën e përcaktuar ligjore të LPP-së. Autoriteti Kontraktues më tej vlerëson se të gjithë tenderët e tenderuesve në aktivitetin e prokurimit në fjalë janë trajtuar në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese ndërsa, i gjithë procesi ka qenë transparent, Vendimi për ta rekomanduar për dhënie të kontratës Grupin e OE. NNP " Hysnia " & " POUK Group "Sh.P.K është marrë në mes tjerash edhe në zbatim të nenit 59 paragrafi 4 te Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Lidhur me pretendimin e Ankuesit për papërgjegjshmëri ndaj OE. të rekomanduar për dhënie të kontratës AK edhe me lartë në këtë Vendim ka sqaruar se sa i përket tenderit me çmim Jo-normalisht të ulët AK, në zbatim të dispozitave te nenit 61 të LPP-së lidhur me nenin 41 paragrafi 41.2 dhe 41.3 te Rregullores e ka trajtuar tenderin konform dispozitave të cituara dhe O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës me sukses dhe në pajtim me dispozitat e nenit 51 të LPP-së me shkrim, përmes Platformës Elektronike, ka ofruar sqarimet e kërkuara, të cilat sikurse

është vlerësuar dhe sqaruar prej AK. kanë qenë sqarime të mjaftueshme, të besueshme dhe mbi k6t6 baz6 AK. e ka radhitur në mesin e tenderëve të përgjegjshëm dhe e ka trajtuar si të tillë deri në vendimmarrje përfundimtare, andaj pretendimet e Ankuesit lidhur me çmimin Jo-normalisht të ulët të tenderit të Grupit të O.E. të rekomanduar për dhënie të kontratës janë vlerësuar si të pabazë dhe si të tilla janë refuzuar. Lidhur me pretendimin e Ankuesit se Grupi i OE. i rekomanduar me dhënie të kontratës nuk përmbush vlerën e referencave për shërbime dhe / ose punë të ngjashme ashtu sikurse 6sht6 sakt6suar në FTD - kërkesat mbi mundësitë teknike dhe / ose profesionale, pika 1, A.K. sqaron se në zbatim të dispozitave të nenit 72 të LPP-se lidhur me nenin 38 të Rregullores ka trajtuar tenderin e Grupit të O.E. duke kërkuar referenca për projektet e listuar në Listën e projekteve të përfunduara në tre vitet e fundit para publikimit të Njoftimit për Kontrate, ndërsa OE në përgjigje të kërkesës të AK. me shkrim, përmes Platformës Elektronike, ka dorëzuar dëshmitë e kërkuara, të cilat A.K. i ka vlerësuar si të mjaftueshme dhe në pajtim me natyrën e aktivitetit të prokurimit. Me këto rast AK ka pasur parasysh faktin se Grupi i OE ka dëshmuar se në vitin 2022/2023 me AK - Komunën e Vushtrrisë ka realizuar me sukses kontratën për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve në territorin e Komunës së Vushtrrisë, se Grupi i OE. ka në dispozicion staf teknik, inxhinjerik, makineri të rregullt dhe të mjaftueshme për ekzekutimin e shërbimeve të natyrës së njëjtë me titullin e aktivitetit të prokurimit në fjalë. Posedimi i makinerisë së mjaftueshme dhe të rregullt si dhe stafit teknik sikurse ka vlerësuar AK janë kërkesat thelbësore të cilat tenderuesi duhet të përmbush, dhe një gjë e tillë nga tenderuesi 6sht6 përmbushur përmes dorëzimit të dëshmitë të dorëzuara dhe / ose kërkuara, andaj edhe ky pretendim i Ankuesit 6sht6 hedhur poshtë si i paqëndrueshëm respektivisht i pa bazuar. Lidhur me pretendimin e Ankuesit se Grupi i OE. nuk ka dorëzuar të notuar dokumentin " Vlerësimi i rrishtit "AK. ka vlerësuar se kjo paraqet një devijim jo substancial dhe jo largim dhe / ose kufizim thelbësor nga Kërkesat teknike të saktësuara në Njoftimin për Kontrate dhe në Dosjen e Tenderit, që nuk afekton parametrat, cilësinë ose ekzekutimin e kontratës, nuk kufizon të drejtat e A.K. ose obligimet e tenderuesit sipas kontratës, se nuk shtrembron konkurrencën e tenderuesve, ofertimet e të cilëve janë pajtueshmëri me rregullat, andaj AK, në zbatim të dispozitave të nenit 72 të LPP-se lidhur me nenin 38 të Rregullores, nga Grupi i O.E. me kërkesë me shkrim përmes Platformës Elektronike, ka kërkuar të dorëzonte të notuar dokumentin " Vlerësimi i rrishtit " të njëjtin dokument të dorëzuar në Dosjen e Tenderit me rastin e aplikimit pa asnjë ndryshim me të vogël, por vetëm me vule të noterit, ndërsa OE në përgjigje të kërkesës të AK. ka dorëzuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt dokumentin e kërkuar, po ashtu përmes Platformës Elektronike, andaj edhe ky pretendim i Ankuesit është hedhur poshtë si i paqëndrueshëm respektivisht i pa bazuar. Edhe pretendimin tjetër i Ankuesit se Grupi i O.E. nuk ka dorëzuar të nënshkruara dokumentin " CV-i " të Inxhinjerit - Menaxherit të Kontratës, z. Azem Gashi, A.K. ka vlerësuar se edhe ky rast paraqet një devijim jo substancial dhe jo largim dhe / ose kufizim thelbësor nga Kërkesat teknike të saktësuara në Njoftimin për Kontrate dhe në Dosjen e Tenderit, që nuk afekton parametrat, cilësinë ose ekzekutimin e kontratës, nuk kufizon të drejtat e AK. ose obligimet e tenderuesit sipas kontratës, se nuk shtremberon konkurrencën e tenderuesve, ofertimet e të cilave janë pajtueshmëri me rregullat. Me këtë rast A.K. ka pasur parasysh se z. Gashi është staf i rregullt i O.E., Se është paraqitur në Administratën Tatimore, se me OE ka kontratë të rregullt pune, andaj A.K. edhe në këtë rast, në zbatim të dispozitave të nenit 72 të LPP-së lidhur me nenin 38 të Rregullores, nga Grupi i OE, me kërkesë me shkrim përmes Platformës Elektronike, ka kërkuar të dorëzojë të nënshkruar prej z. Gashi dokumentin "CV", të njëjtin dokument të dorëzuar në Dosjen e Tenderit me rastin e aplikimit pa asnjë ndryshim më të vogël, por vetëm me nënshkrime të z. Gashi, ndërsa OE në përgjigje të kërkesës të A.K. ka dorëzuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt dokumentin e kërkuar, po ashtu përmes Platformës Elektronike, andaj edhe ky pretendim i Ankuesit është hedhur poshtë si i

paqëndrueshëm respektivisht i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e Ankuesit se OE në listën e stafit ka të evidentuar edhe staf inxhinierik dhe si të tillë stafi inxhinierik nuk duhet marrë në konsideratë si staf teknik, dhe po ashtu se nuk ka staf të mjaftueshëm, respektivisht nuk i ka të dëshmuar 20 punëtorë në Listën e stafit, A.K. sqaron se Lista e stafit është e dorëzuar në rregull, se dëshmitë e dorëzuara, kontratat e punës të stafit të listuar janë dorëzuar të rregullta dhe tregojnë qartë se OE e përmbush edhe këtë Kërkesë, ndërsa sa i përket kontratës së punës të Arbnor Shabani, A.K. ka vlerësuar, bazuar në sqarimin e OE, se biznesi i OE ka edhe staf familjar, dhe në mesin e tyre është edhe Arbnor Shabani, ndërsa mungesa e nënshkrimit në kontratë është vlerësuar devijim jo substancial dhe jo largim dhe/ose kufizim thelbësor nga Kërkesat teknike të saktësuara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit, që nuk afekton parametrat, cilësinë ose ekzekutimin e kontratës, nuk kufizon të drejtat e A.K. ose obligimet e tenderuesit sipas kontratës, se nuk shtrembëron konkurrencën e tenderuesve, ofertimet e të cilëve janë pajtueshmëri me rregullat, andaj edhe ky pretendim i Ankuesit është hedhur poshtë si i pabazuar.

Ndërsa, lidhur me pretendimin se dëshmitë lidhur me Traktorët nuk janë të plota pasi që traktorët nuk janë të regjistruar, nga procesi i ri-vlerësimit A.K. edhe një herë vlerësoi dhe erdhi në përfundim se Grupi i OE e përmbushë këtë kërkesë sa i përket çështjes së regjistrimit të traktorëve, pasi që Komisioni i rivlerësimit dhe A.K. erdhën në përfundim dhe vlerësimin se të regjistruara janë kërkuar vetëm automjetet, ndërkaq që traktori nuk bën pjesë në grupin e automjeteve pasi që konsiderohen mjete pune dhe si të tilla nuk kërkohen të jenë të regjistruar.

Çështjet tjera të ngritura nga Ankuesi në fazën e parë janë përmbushur dhe/ose zgjidhur nga OE bazuar në kërkesën e A.K. mbi bazën e zbatimit të dispozitave të nenit 72 lidhur me nenin 59 të LPP-së. Bazuar në të gjitha të cekurat si më lartë në këtë Vendim, A.K. vlerëson se pretendimet e Ankuesit të saktësuar në Ankesën e tij janë të pabazuara, të pasakta.

Përfundimisht, A.K. vlerëson se me rastin e marrjes së vendimit si ai i dt. 29.03.2024 për të rekomanduar për dhënie të kontratës Grupin e OE NNP "Hysnia" & "POUK Group" sh.p.k. nuk ka elemente apo prova se janë shkelur dispozitat e cituara si më lartë në këtë Vendim, me theks të veçantë neni 1 - Qëllimi, neni 7 - Barazia në trajtim/Jo diskriminimi sepse nuk është vërtetuar se ndonjë OE është trajtuar jo barabartë apo diskriminuar, nuk është vërtetuar se nuk ka pasur transparencë apo konkurrencë në mes OE, neni 52 - Njoftimi i kriterëve të dhënies së kontratës dhe neni 59 parag.4 Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, andaj edhe pretendimet e Ankuesit lidhur me këto çështje, sikurse ka konstatuar dhe sqaruar A.K. përmes këtij Vendimi, janë të pabaza, jo të sakta dhe si të tilla janë hedhur poshtë.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 18.04.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 322/2024, ndërsa me datë 28.04.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/322 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues: - Ankesa e Grupit të Operatorëve Ekonomik ankues GOE Eco Clean & Energy; Dardaniaa Sh.P.K aprovohet si e bazuar - lënda të kthehet në rivlerësim dhe të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar rreth rekomandimeve të raportit të ekspertin shqyrtuese, ndërsa OE është pajtuar lidhur me mendimin e ekspertit .

-Vlerësimi i pretendimit ankimor GOE; Eco Clean & Energy; Dardaniaa Sh.P.K ,eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/322 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i ekspertit shqyrtues: Lidhur me pretendimin për Njoftimin e Vendimit të AK, hidhet poshtë i gjithë pretendimi, pasi Autoriteti Kontraktues ka publikuar vendimin brenda suazave ligjore dhe ditët e përlogaritura për njoftimin e vendimit të AK janë ditë kalendarike. Prandaj, AK ka vepruar konform dhe në pajtim të plotë me Nenin 42, Njoftimi i Tenderuesve/Kandidatëve. Sipas Nenit 42.1, të gjithë tenderuesit/kandidatët duhet të informohen nga AK përmes publikimit të Formularit B58 “Njoftimi mbi Vendimin e AK”. Formulari B58 duhet të përmbajë vendimin mbi rezultatin e aktivitetit të prokurimit dhe letrat standarde përkatëse për tenderuesit me arsyetimet e nevojshme, sipas Neneve 42.6 dhe 42.7 pika (a) dhe (b).

Lidhur me pretendimin numër 2, Autoriteti Kontraktues më datë 23.03.2024 ka kërkuar sqarim lidhur me çmimet për tenderët jo-normalisht të ulët dhe ka pranuar sqarimet nga operatori ekonomik më datë 26.03.2024. Eksperti vlerëson se AK ka vepruar pjesërisht në pajtim me LPP-në, pasi vlera e parashikuar e kontratës dhe ofertat e dy operatorëve ekonomikë konkurrues janë në disproporcion të madh në raport me vlerën e parashikuar të kontratës, të vendosur nga vetë AK, Komuna e Vushtrrisë. Sipas Nenit 13 të LPP-së dhe RRPP 002/2022, AK është përgjegjës për krahasimin e çmimeve të tregut dhe analizën e kostos së specifikimeve relevante teknike. Eksperti Shqyrtues vlerëson se AK është dashur të bëjë një matje të çmimeve reale të tregut për të pasur një pasqyrë të qartë lidhur me çmimet e ofruara nga operatori ekonomik i shpallur fitues.

Lidhur me pretendimin numër 4, 5 dhe 6, AK ka kërkuar sqarime shtesë nga grupi i operatorëve ekonomikë N.N.P. HYSNIA; POUK Group SH.P.K. për referencën, CV-në dhe deklaratën e vlerësimit të rrezikut të noterizuar. Dokumentet shtesë janë dorëzuar pas datës së njoftimit për kontratë më 27.12.2023, duke shkelur Nenin 38.2 dhe 38.3 të LPP-së, që ndalon ndryshimet materiale pas datës së publikimit të njoftimit për kontratë. Eksperti Shqyrtues vlerëson se AK ka vepruar në kundërshtim me nenet e lartëcekura.

Lidhur me pretendimin numër 8, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar dëshmi lidhur me listën e pajisjeve të paraqitura, por operatori ekonomik nuk ka ofruar të gjitha dëshmitë lidhur me pronësinë e pajisjeve të kërkuara nga AK.

Lidhur me pretendimin numër 9, grupi i operatorëve ekonomikë N.N.P. HYSNIA; POUK Group SH.P.K. nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për të konsideruar kërkesën si të përgjegjshme.

Përfundim: Eksperti Shqyrtues, pas vlerësimit dhe analizimit të detajuar të kërkesave të Autoritetit Kontraktues dhe ankesave të operatorit ekonomik ankues, Grupit të Operatorëve Ekonomik ECO CLEAN & ENERGY; DARDANIA SH.P.K., ka konstatuar se AK ka vepruar në përputhje me ligjin në disa aspekte dhe në kundërshtim në disa të tjera.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e grupit të operatorëve ekonomik ankues Eco Clean & Energy; Dardaniaa Sh.P.K

Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertes. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e grupit të operatorëve ekonomik ankues Eco Clean & Energy; Dardaniaa Sh.P.K janë të bazuara.

Rekomandimi e ekspertit shqyrtues:

Ankesa e Grupit të Operatorëve Ekonomik ankues GOE Eco Clean & Energy; Dardaniaa Sh.P.K aprovohet si e bazuar - lënda të kthehet në rivlerësim dhe të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrësat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve me numër të prokurimit: “VU644-23-14245-2-1-1”. Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e GOE ankues Eco Clean & Energy; Dardaniaa Sh.P.K

dhe se, argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Vlerësimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e GOE ankues Eco Clean & Energy; Dardaniaa Sh.P.K janë të bazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Grupit të Operatorëve Ekonomik aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve me numër të prokurimit: "VU644-23- 14245-2-1-1", të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura dhe pas shqyrtimit të lëndës, ankesën e grupit të operatorëve ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës , ankesën e operatorit e sheh si të bazuar, duke rekomanduar që aktiviteti i prokurimit me titull "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve me numër të prokurimit: "VU644-23- 14245-2-1-1", të rivlerësohet dhe AK të veprojnë në raport me dispozitat ligjore të LLP-së , vlerësimet të bazuara të ekspertit shqyrtues, kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim.

Paneli duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjellojë sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Krahas tjerash në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje lidhur me pretendimet ankimore, prandaj Paneli shqyrtues mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues për aprovimin e ankesës së GOE ankues; Eco Clean & Energy; Dardaniaa Sh.P.K, anulimin e vendimit të AK- Komuna Vushtrrisë dhe kthimin e aktivitetit të prokurimit në Rivlersim.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj" lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themelojë një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të ankese të GOE; Eco Clean & Energy; Dardaniaa Sh.P.K, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori

ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E VUSHTRRIË**
- **OE - Muhamet Muçiqi**
- Arkivës së OSHP-së: